



## UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” UNIVERSITY

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112  
Ref. nr.01/268-1, Datë 23 /02 / 2017

---

Në bazë të Statutit të Përkoħshäm të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan, Senati në mbledhjen e mbajtur më 16/02 / 2017, miratoi:

### RREGULLORE për themelin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan

#### Qëllimi

Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësimin, funksionimin, fushëveprimin, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Bordit Këshillëdhënës i Bashkësisë (BKB).

#### Neni 1

1. Karakteri i Bordit Këshillëdhënës të Bashkësisë (në tekstin e mëtejmë Bordi), i themeluar në bazë të të Statutit të Pérkoħshäm të Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan (në tekstin e mëtejmë Universiteti) dhe të kësaj Rregulloreje, *është jo fitimprurës dhe këshillëdhënës* dhe bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe përkushtimin e Universitetit pér ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e veprimitarisë së tij.
2. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e tregut të punës dhe të autoriteteteve nga fushë-veprimtaria e Universitetit.
3. Përbërja dhe aktivitetet e Bordit publikohen në web faqen e Universitetit.

#### Neni 2

1. Bordin e themelon Senati i Universitetit me propozimin e Rektorit.
2. Bordi përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha ndërmarrjeve dhe institucioneve me të cilat Universiteti ka një bashkëpunim të theksuar në tregun e punës, ose në një aspekt tjetër kanë të ndërlidhur me fushëveprimin e Universitetit.

3. Pas konstituimit të Bordit dhe zgjedhjes së Kryetarit, Bordit mund t'i bashkohen edhe anëtarë te tjerë, me të njëjtën procedurë sikurse themelimi i tij.

### Neni 3

1. Anëtarë ex-officio të Bordit janë Rektori, Prorektorët dhe Dekanët e njësive akademike, si dhe një përfaqësues nga administrata e Universiteti.
2. Rektori përgatit mbledhjen konstitutive të Bordit, përpilon materialet lidhur me rendin e ditës dhe ndërmerr aktivitete tjera për mbarëvajtjen e punës së Bordit.

### Neni 4

1. Bordi e zgjedh Kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari i Bordit i udhëheq mbledhjet dhe kujdeset që informatat lidhur me mbledhjet të shpërndahen te të gjithë anëtarët e vet dhe palëve tjera të interesit.
2. Sipas kësaj rregulloreje dhe praktikës së mirë dhe transparente, Kryetari i Bordit përkujdeset përmbladhjen e raporteve të punës së Bordit dhe operacionalizimin e iniciativave të tij.
3. Kryetari i Bordit e përfaqëson atë në raport me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit, ai/ajo mund të caktojë një zëvendës të tij.
4. Kryetari i Bordit prezanton punën e Bordit në organizime të ndryshme, si: Këshilli Mësimor/Shkencorë, Senati, Këshilli Drejtues, institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike, etj.
5. Bordi mund të formoj grupe punuese që përqendrohen në lëmi të veçanta të fushëveprimit të Universitetit.
6. Varësisht nga temat për diskutim, në mbledhjet e Bordit mund të ftohen Drejtorët e Departamenteve dhe Udhëheqësit e programeve të studimit, Drejtori i Institutit dhe drejtë vote.

### Neni 5

1. Bordi mund t'i sugjerojë Këshillit Mësimor/Shkencorë dhe Senatit përditësimin e programeve të studimeve.
2. Anëtarët e Bordit mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të Universitetit, në pajtim me programet e studimeve.
3. Bordi mbështet Universitetit dhe tregun e punës të fushë-veprimtarisë punuese në krijimin e grupeve të përbashkëta punuese.
4. Bordi dhe Universiteti bashkëpunojnë në kërkime shkencore, shërbime profesionale, bashkëpunime në projekte, ndërmjetësim për inovacione, si dhe në propozime për bashkëpunim në projekte të përbashkëta me Universitetin dhe partner të tjerë.
5. Anëtarët e Bordit mund të ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe stafit akademik.
6. Bordi mund të shqyrtojë edhe çështje tjera të propozuara nga Rektori.

## Neni 6

1. Bordi mund të sugjerojë ndryshimin, përmirësimin dhe amandamentimin e rregulloreve dhe akteve tjera në fuqi.
2. Bordi mund t'i propozojë Këshillit Mësimor/Shkencorë dhe Senatit programe që kanë të bëjnë me: mësim terëjetësor, aftësimin e të rriturve dhe trajnime profesionale.
3. Bordi bënë vlerësimë, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
4. Këshillat dhe sugjerimet e Bordit për çështjet e trajtuara, do t'i adresohen Këshillit Mësimor/Shkencorë, Senatit, Menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të Universitetit, në kuadër të: hartimit të programeve të reja, aplikimit për proces të akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit projekteve kërkimore-shkencore, vlerësimit të tyre, hartimit të dokumenteve strategjike, etj.

## Neni 7

1. Aprovimi i propozimeve bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Rekomandimet e Bordit, në formë të propozimit dorëzohen në Senat.

## Neni 8


1. Mandati i anëtarëve të Bordit zgjat 4 (katër) vite, me mundësi të rizgjedhjes. Numri i mandateve nuk është i kufizuar.
2. Me ftesën e Rektorit, Kryetari i Bordit mund të prezantojë para Senatit aktivitetet e Bordit për periudhën e caktuar.

## Neni 9

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në 7 ditë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Senatit të Universitetit.



Kryesuesi i Senatit të Universitetit  
"Kadri Zeka" në Gjilan

  
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi  
R E K T O R